



## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI NJË VIZITË ZYRTARE NË SHBA

Faqe 2-3

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, organizuar nga OPDAT (Zyra Transoqeanike për Zhvillimin, Ndihmën dhe Trajnimin e Prokurorisë) e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së. Z. Metani zhvilloi takime të rëndësishme me përfaqësues të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm në Departamentin e Drejtësisë, si dhe me përfaqësues të OPDAT.



### ILD në shifra

**31 vendime nga 53 praktika të trajtuara:**  
23 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar  
8 vendime arkivimi pas verifikimit

**13 vendime verifikimi**

**3 vendime për fillim hetimi disiplinor**  
për 2 magjistratë (gjyqtare) dhe 1 magjistrat (prokurore)  
**3 vendime për përfundim hetimi disiplinor**  
për 2 magjistratë (prokurorë) dhe 1 magjistrat (gjyqtar)  
**1 kërkesë për procedim disiplinor**  
për 2 magjistratë (prokurore)

**1 inspektim i përfunduar** "Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm" Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër për periudhën 01.01.2025- 31.10.2025

### Qytetari në Zyrën e ILD-së

#### Gjatë muajit Prill 2026:

- janë pritur **35 ankes**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- janë realizuar **26 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës;
- janë trajtuar **13 kërkesa** për informacion.

Vizitë zyrtare e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në shtetet e Teksasit dhe Floridës në SHBA *Fq. 4-7*

Përzgjidhet Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë *Fq. 8-10*

Tri institucione të drejtësisë bashkëbisedim me juristë të Diasporës *Fq. 14-18*

Fjala e Z. Metani në takimin e këshillave për vlerësimet etiko- profesionale dhe uljen e backlog-ut *Fq. 19-20*

ILD dhe MD nënshkruajnë për të dhënat statistikore të sistemit të drejtësisë *Fq. 21-22*

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në aktivitetin e nënshkrimit të marrëveshjes për harmonizimin e statistikave të sistemit të drejtësisë *Fq. 23-24*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, leksion i hapur me studentët e "Luarasi" *Fq. 25-30*

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI NJË VIZITË ZYRTARE NË SHBA



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani zhvilloi një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, organizuar nga OPDAT (Zyra Transoqeanike për Zhvillimin, Ndihmën dhe Trajnimin e Prokurorisë) e Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së. Z. Metani zhvilloi takime të rëndësishme me përfaqësues të Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm në Departamentin e Drejtësisë, si dhe me përfaqësues të OPDAT.

Në zyrën e OPDAT, z. Metani u takua me Zëvendësdrejtorin George Huber dhe Drejtorin Rajonale për Evropën Pragna Soni. Gjatë këtyre takimeve Inspektori i Lartë i Drejtësisë u shoqërua nga Këshilltari Ligjor Rezident i OPDAT në Shqipëri, Dave Backman, si dhe nga inspektori z. Periand Teta.

Diskutimet u përqendruan në rritjen e standardeve të integritetit dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor në Shqipëri, si elemente thelbësore në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në këtë kontekst, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndau pikëpamje mbi rëndësinë e forcimit të mekanizmave të inspektimit dhe llogaridhënies për gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe nevojën për të garantuar standarde të larta etike dhe profesionale.

Z. Metani theksoi gjithashtu se funksionimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe të përgjegjshëm përbën një element kyç në garantimin e shtetit të së drejtës dhe forcimin e demokracisë në Shqipëri. Bashkëbiseduesit vlerësuan progresin e arritur dhe shprehën gatishmërinë për të vijuar mbështetjen dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në drejtim të asistencës teknike, si dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.

Këto takime përbëjnë një hap të rëndësishëm në thellimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe avancimin e reformave në sistemin e drejtësisë, me synim rritjen e besimit të publikut dhe forcimin e institucioneve të drejtësisë në Shqipëri.



## VIZITË ZYRTARE E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË SHTETET E TEKSASIT DHE FLORIDËS NË SHBA



Në kuadër të vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani, zhvilloi një vizitë në shtetin e Teksasit, gjatë së cilës realizoi një sërë takimesh të nivelit të lartë institucional me përfaqësues të institucioneve publike dhe aktorë të sistemit të drejtësisë. Këto takime u organizuan me mbështetjen e anëtarit të Këshillit të Qarkut Conroe, z. Harry Hardman, si dhe të organizatës Open Gov Hub Albania, në funksion të thellimit të dialogut ndërinstitucional dhe promovimit të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira profesionale ndërmjet institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe institucioneve të tjera publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në nderim të vizitës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në shtetin e Teksasit, mirëseardhja u shënuar përmes një ceremonie simbolike të ngritjes së flamurit për një ditë në Austin, në Kapitolin e shtetit të Teksasit, si një akt me rëndësi të veçantë protokollare dhe institucionale. Në vijim, gjatë një ceremonie zyrtare të organizuar me praninë e autoriteteve vendore, në shenjë vlerësimi dhe respekti reciprok ndërinstitucional, flamuri iu dorëzua z. Metani në emër të z. Will Metcalf, Anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të Teksasit, Distrikti i 16-të, nga Kryetari i Bashkisë së Conroe, z. Duke Coon.

Në vijim të agjendës zyrtare, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi gjithashtu një vizitë në Shkollën Bush të Qeverisjes dhe Shërbimit Publik pranë Texas A&M University, ku u prit nga Dekania e Asociuar Ekzekutive, Prof. Maria Escobar-Lemmon dhe Dekani i Asociuar, Prof. Robert R. Shandley. Gjatë këtij takimi u trajtuan në mënyrë të thelluar çështje që lidhen me programet akademike dhe rolin thelbësor të trajnimit të vazhdueshëm profesional në konsolidimin dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në këtë kuadër, palët evidentuan fusha konkrete bashkëpunimi dhe diskutuan mbi ndërtimin e një partneriteti të qëndrueshëm dhe afatgjatë ndërinstitucional ndërmjet universitetit dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me synim promovimin e shkëmbimit të programeve akademike, transferimin e njohurive dhe realizimin e trajnimeve të specializuara për stafin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Shkolla Bush.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani u prit në Prokurorinë e Qarkut Montgomery nga Prokurori i Qarkut, Mike Holley. Gjatë këtij takimi, bashkëbiseduesit shkëmbyen në mënyrë të detajuar përvojat e tyre institucionale dhe praktikatat më të mira profesionale, të cilat duhet të ndiqen në funksion të rritjes së pavarësisë, llogaridhënies, garantimit të integritetit institucional të prokurorëve dhe konsolidimit të mëtejshëm të parimeve të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike. Në përfundim të takimit, Prokurori Holley i dorëzoi z. Metani certifikatën e Zyrës së Prokurorit të Qarkut në nderim të vizitës, me këtë vlerësim: “Puna juaj pasqyron parimet më të larta të integritetit, llogaridhënies dhe shërbimit publik, duke forcuar ndjekjen e drejtësisë si brenda kombit tuaj, ashtu edhe në të gjithë komunitetin global.”

Gjatë vizitës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një takim me gjyqtarin Jay Wright, të Gjykatës së 9-të të Apelit të Teksasit, në kuadër të shkëmbimit të përvojave mbi organizimin, funksionimin dhe standardet e praktikës gjyqësore.

Në kuadër të vizitës në Teksas, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u ftua në Parkun Përkujtimor të Veteranëve të Qarkut Montgomery, ku u njoh nga afër me misionin, rolin dhe veprimtarinë e kësaj qendre,

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

e cila i dedikohet nderimit të sakrificave të veteranëve të Shteteve të Bashkuara, ushtarakëve në detyrë aktive dhe reaguesve të parë nga të gjitha shtetet. Me këtë rast, atij iu dorëzua një certifikatë falënderimi për vizitën, si shprehje e mirënjohjes institucionale.

Në vijim të vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi gjithashtu një vizitë pune, edhe në shtetin e Floridës i shoqëruar nga organizatorja e vizitës, Dr. Judithanne Scourfield McLauchlan, Professore e Asociuar e Shkencave Politike në Universitetin e Floridës Jugore, Shën Petersburg. Gjatë qëndrimit në Florida, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një sërë takimesh me magjistratë dhe përfaqësues të botës akademike, me fokus të veçantë analizimin e modeleve të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe standardeve të integritetit institucional të magjistratëve. Në këtë kuadër, u realizuan takime me gjyqtaren magjistrate federale Natalie Hirt Adams të Gjykatës së Qarkut të Mesëm të Floridës, si dhe me gjyqtarët Pat Siracusa dhe Keith Meyer të Gjykatës së Qarkut të 6-të të Floridës, ku u shkëmbyen opinione dhe përvoja mbi mekanizmat e administrimit të drejtësisë, etikën gjyqësore, si dhe garancitë procedurale në funksion të forcimit të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike.

Në vijim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi gjithashtu një takim me Dr. Thomas Smith, Kancelar i Përkohshëm Rajonal dhe Zëvendës Rektor për Çështjet Akademike në Universitetin e Floridës Jugore, Shën Petersburg, gjatë të cilit u trajtuan çështje që lidhen me bashkëpunimin ndërinstitucional, zhvillimin e programeve të përbashkëta akademike dhe profesionale, si dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për shkëmbim ekspertize dhe ngritje kapaciteteve institucionale të stafit të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këto takime përbëjnë një hap të rëndësishëm në drejtim të thellimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të avancimit të mëtejshëm të reformave në sistemin e drejtësisë, duke synuar konsolidimin e standardeve institucionale të ILD-së dhe përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë kuadër, këto angazhime synojnë rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe forcimin e kapaciteteve institucionale të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe standardet bashkëkohore të qeverisjes demokratike.







## PËRZGJIDHET ZËVENDESINSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi procedurën për përzgjedhjen e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje me ligjin nr. 115/2016, i ndryshuar, dhe vendimin nr. 65, datë 09.11.2023.

Pas shqyrtimit të kandidaturës së paraqitur dhe zhvillimit të votimit të fshehtë nga Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve, kjo e fundit vendosi t'i propozojë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidaturën e znj. Elena Pelushi për emërim si Zëvendësinspektor i Lartë i Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani, duke marrë në konsideratë mendimin këshillues të Mbledhjes së Përgjithshme të Inspektorëve, vendosi emërimin e znj. Pelushi në këtë detyrë.

Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë, znj. Elena Pelushi, ka përfunduar në vitin 2002 Shkollën e Magjistraturës, profili prokuror. Në vijim, ajo ka ushtruar funksionin e prokurorit deri në shkurt të vitit 2021,

kur është komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të ushtruar detyrën e inspektorit magjistrat.

Gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror, znj. Pelushi është angazhuar në një sërë trajnimesh profesionale të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe institucione e organizma të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ajo zotëron gjuhën frënge, italiane dhe angleze.

Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë ushtron të gjitha kompetencat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mungesë të këtij të fundit, ose kur vendi i tij është përkohësisht i lirë, me përjashtim të kompetencave organike, që lidhen me nxjerrjen e urdhrave për mbarëvajtjen e punës, verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe inspektimin, si dhe garantimin e zbatimit të rregullave etike dhe profesionale nga inspektorët dhe personeli administrativ. Zëvendësinspektori i Lartë i Drejtësisë qëndron në detyrë për një periudhë dyvjeçare, me të drejtë riemërimi.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR



## PRILLI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit Prill 2026 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **116 ankesa** të cilat janë **depozituar nga qytetarë**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit Prill 2026.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR	INSPEKTIVE
<b>31 vendime nga 53 praktika të trajtuara:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>· 23 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar</li><li>· 8 vendime arkivimi pas verifikimit</li></ul>	<b>13 vendime verifikimi</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• <b>3 vendime për fillim hetimi disiplinor</b> për 2 magjistratë (gjyqtare) dhe 1 magjistrat (prokurore)</li><li>• <b>3 vendime për përfundim hetimi disiplinor</b> për 2 magjistratë (prokurorë) dhe 1 magjistrat (gjyqtar)</li><li>• <b>1 kërkesë për procedim disiplinor</b> për 1 magjistrat (prokurore)</li></ul>	<b>1 inspektim i përfunduar:</b> <b>“Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave në disa Gjykata të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”</b> Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Korçë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër për periudhën 01.01.2025 - 31.10.2025.

## ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankesë, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al) ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin **“Si pranohen ankesat”**.



### *Gjatë asistimit të ankuesve*


Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217. Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



## SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Prill 2026**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **6 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



## KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: [info@ild.al](mailto:info@ild.al), si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit [elis.kuci@ild.al](mailto:elis.kuci@ild.al)

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Prill 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **13 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

## TRI INSTITUCIONE TË DREJTËSISË BASHKËBISEDIM ME JURISTË TË DIASPORËS



Shoqata e avokatëve shqiptaro-britanikë (BALA), në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, organizoi një bashkëbisedim panelistësh të nivelit të lartë me juristë nga diaspora shqiptare, të cilët ndodheshin në Tiranë në kuadër të Samitit të IV të Diasporës.

Në takimin, i cili u mikprit nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani, morën pjesë gjithashtu Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi dhe Prokurori i Përgjithshëm, Olsian Çela.

Diskutimi i moderuar nga kryetarja e Shoqatës së avokatëve shqiptaro-britanikë, znj. Brikena Muharremi, u fokusua në temën “Reforma në drejtësi në Shqipëri dhe kontributi i diasporës shqiptare për shtetin e së drejtës”, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit mes institucioneve vendase dhe ekspertizës së diasporës në forcimin e sistemit të drejtësisë.

Duke u uruar mirëseardhjen pjesëmarrësve, z. Metani u shpreh se institucionet kanë detyrimin, që marrëdhënia me shqiptarët që jetojnë jashtë vendit të marrë të njëjtën vëmendje, si ajo me qytetarët që jetojnë në Shqipëri.

Gjatë një prezantimi të shkurtër të funksioneve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ai theksoi se themeli i punës së këtij institucioni është gjetja e balancës mes përgjegjshmërisë që duhet të kenë magjistratët për funksionin e tyre dhe respektimit të pavarësisë së tyre. Sipas tij, kontrolli nga ILD nuk është çështje emocionale, por një detyrim që buron nga ligji. Z. Metani nënvizoi se është thelbësore që gjyqtarët dhe prokurorët të ndiejnë se puna e tyre kontrollohet në mënyrë kushtetuese.

Prokurori i Përgjithshëm Olsian Çela, e vlerësoi takimin si të rëndësishëm, duke theksuar se është thelbësore, që profesionistët e ardhur nga diaspora të kuptojnë shërbimin që ofron institucioni i prokurorisë dhe të kenë një perceptim të drejtë mbi punën e tij. Ai u ndal te transformimi i thellë që ka pësuar sistemi për shkak të reformës në drejtësi, duke evidentuar se pritshmëritë e publikut janë të larta, por kjo është një sfidë afatgjatë dhe e perditshme. Si një nga risitë kryesore të reformës në drejtësi, z. Çela evidentoi faktin se sistemi i prokurorisë tashmë është tërësisht i decentralizuar dhe pavaresinë e prokurorëve, që e ka bërë edhe më kompleks menaxhimin e sistemit.

Juristët nga diaspora, të ardhur nga Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania dhe Zvicra, u interesuan mbi mundësitë konkrete për të kontribuar në Shqipëri.

Metani solli rastin e ILD-së, duke bërë të ditur se dy studentë të drejtësisë që jetojnë në Londër, do të kryejnë praktikë (internship) pranë këtij institucioni në muajin qershor, ndërsa tri kërkesa të tjera janë në shqyrtim. Ai theksoi se institucioni mirëpret çdo kontribut, si për punësim, sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin shqiptar, ashtu edhe për angazhime konsulence apo studimore.

Lidhur me kontributin konkret të diasporës, z. Rusi u shpreh se dyert e Këshillit të Lartë Gjyqësor janë të hapura për profesionistët e fushës sipas kriterëve ligjore, dhe akoma më shumë për studentët e interesuar për mundësi praktike. Ai bëri të ditur se KLGJ ka shpallur thirrje për lehtësues dhe trajnues për administratën gjyqësore dhe përmes bashkëpunimit me partnerë si Bashkimi Evropian, OSBE dhe Këshilli i Evropës, çdo i interesuar mund të bëhet pjesë.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Nga ana e tij Prokurori i Përgjithshëm Olsian Çela evidentoi se në fazën negociuese ku ndodhet Shqipëria në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, çdo kontribut nga diaspora shqiptare është i mirëpritur dhe me interes për arritjen e këtij objekti kombëtar. Në përgjigje të interesimit për rritjen e besimit të publikut, tre drejtuesit e institucioneve u shprehën se pritshmëritë e larta mbeten një sfidë, por përpjekjet janë të vazhdueshme, që vendimmarrja të bazohet jo në emocione të momentit, por në zgjidhje të qëndrueshme dhe të mbështetura në ligj, të cilat i rezistojnë kohës.

“Reforma në drejtësi ka ndërtuar një arkitekturë të re të ndarjes së pushteteve, duke garantuar njëkohësisht pavarësinë dhe mekanizmat e kontrollit. Një element i rëndësishëm për besimin publik është pikërisht kjo arkitekturë, ku institucionet kontrollojnë njëra-tjetrën. Në këtë kuptim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk është një autoritet absolut, pasi vendimet e tij mund të ankimohen dhe kontrollohen nga Këshillat. Nga ana tjetër, vendimet e Këshillave i nënshtrohen kontrollit nga trupat gjyqësore të apelimit, ndërsa vetë Këshillat kontrollohen nga ILD. Kështu, e gjithë struktura e reformës mbështetet mbi parimin e ndarjes së pushteteve, por edhe mbi kontrollin dhe balancën ndërmjet tyre.”, u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani.







INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR



## ILD DHE MD NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR TË DHËNAT STATISTIKORE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË



Në një ceremoni të veçantë, marrëveshja u nënshkrua në emër të institucioneve përkatëse nga z. Artur Metani dhe z. Toni Gogu. Ajo synon të krijojë një kuadër bashkëpunimi ndërinstitucional dhe të rregullojë proceset e mbledhjes, përpunimit, raportimit dhe publikimit të të dhënave statistikore të sistemit të drejtësisë, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe legjislacionin kombëtar në fuqi.

Në fjalën e tij, z. Metani theksoi se ndërtimi i një sistemi me të dhëna statistikore të sakta dhe të aksesueshme i shërben jo vetëm matjes së performancës dhe efikasitetit të gjykatave dhe prokurorive, por është gjithashtu thelbësor për rritjen e transparencës, forcimin e llogaridhënies dhe identifikimin e nevojave për përmirësim të vazhdueshëm në funksionimin e sistemit të drejtësisë. “Vetëm nëse arrijmë të krijojmë të realizojmë një fotografim të plotë dhe të saktë të gjendjes të sistemit të drejtësisë (lidhur me kohën mesatare që i nevojitet një magjistrati për shqyrtimin gjyqësor, ecurinë dhe përfundimin e çështjeve të prapambetura në gjykata, ngarkesën e tyre) mund të arrijmë të evidentojmë masa konkrete, vlerësime të sakta dhe strategji efektive të cilat përbushin qëllimin për rritjen e cilësisë edhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë.”, tha z. Metani.

Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nënvizoi edhe ndikimin e statistikave tek vetë proceset e punës së institucionit që drejton. “Statistikat e sistemit të drejtësisë kanë një impakt të tërëndësishëm dhe në planifikimin e inspektimeve tematike të cilat prekin problematikat më thelbësore të sistemit të drejtësisë duke rritur efektivitetin e rekomandimeve. Qartësia, kuptueshmëria dhe saktësia e të dhënave statistikore kontribuon edhe në vlerësimin e ndikimit të inspektimeve tematike dhe institucionale të përfunduara.

*Duke krahasuar statistikën e sistemit të drejtësisë para dhe pas çdo inspektimi, mund të vlerësohet më efektivisht impakti i rekomandimeve në përmirësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë si dhe besimi i publikut në këtë sistem. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që të sigurohet standardizimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe ndërtimi i sistemeve të integruara që garantojnë transparencë, gjurmueshmëri dhe akses të kontrolluar në informacion. Vetëm përmes një infrastrukture të tillë mund të arrihet që të dhënat statistikore të shndërrohen në një instrument real vendimmarrjeje, i cili mbështet një vlerësim të drejtë dhe të mbështetur në të dhëna të sakta. Njëkohësisht, ky proces nuk mund të kuptohet i shkëputur nga infrastruktura, kushtet materiale dhe funksionale në të cilat ushtrohet veprimtaria e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Për këtë arsye, përmirësimi i infrastrukturës dhe i sistemeve të gjykatave dhe prokurorive përbën një komponent thelbësor, i cili ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e punës, në cilësinë e të dhënave”.*

Në praninë e Ambasadorit të Bashkimit Evropian në Shqipëri z. Silvio Gonzato, marrëveshje të ngjashme u nënshkruan sot me Ministrinë e Drejtësisë edhe nga institucione të tjera të sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Shkolla e Magjistraturës.

Këto marrëveshje janë pjesë e Agjendës Kombëtare të Reformave dhe lidhen drejtpërdrejt me objektivin për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë në të gjitha nivelet. Ato kontribuojnë në mënyrë konkrete në procesin e integritetit evropian, duke garantuar të dhëna të krahasueshme dhe të besueshme për raportimet ndaj Komisionit Evropian.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR



## FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË AKTIVITETIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES PËR HARMONIZIMIN E STATISTIKAVE TË SISTEMIT TË DREJTËSISË



I nderuar zoti ministër,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore,

I nderuar ambasador,

Të nderuar kolegë dhe të pranishëm,

Më lejoni që në fillim t'ju them se është një kënaqësi e veçantë për mua, që sot ndodhemi në këtë moment të rëndësishëm të formalizimit të një bashkëpunimi që i shërben drejtpërdrejt forcimit të transparencës dhe rritjes së efikasitetit të sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

Nënskrimi i kësaj marrëveshjeje ndërmjet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Drejtësisë nuk është thjesht një akt formal, apo vetëm harmonizim i metodologjisë së mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave statistikore me standardet e Komisionit Evropian në kuadër të procesit të integritimit evropian, por një hap konkret drejt ndërtimit të një sistemi më transparent, më të përgjegjshëm dhe më efikas, përmes përmirësimit të mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave statistikore në drejtësi.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë si bashkëkontributor thelbësor në zbatimin e prioritetëve të Kapitullit 23, ka patur rol aktiv në ndjekjen e tyre me përparësi absolute, duke ndërmarrë hapa konkrete në praktikën dhe standardet e punës. Dhe jo vetëm në drejtim të harmonizimit të të dhënave, por edhe duke nxitur e vënë në zbatim praktikën pune, sipas standardeve më të larta evropiane si modeli drejt të cilit, aspirojnë institucionet tona, shoqëria dhe vendi ynë.

Nisur nga fakti se besimi i publikut ndaj institucioneve të Drejtësisë është thelbësor, të dhënat e sakta dhe të besueshme luajnë një rol kyç, jo vetëm si tregues të performancës sonë, por edhe instrumente të rëndësishme për hartimin e politikave të drejta, për identifikimin e problematikave dhe për ndërmarrjen e reformave të qëndrueshme dhe metodologjive funksionale për çdo institucion të Drejtësisë në vend dhe padyshim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ngritja e një të sistemi me të dhëna të sakta dhe të aksesueshme statistikore i shërben jo vetëm jo vetëm matjes së performancës dhe efikasitetit të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorive, por është thelbësor dhe në drejtim të transparencës, llogaridhënies si dhe identifikimit të nevojave për përmirësim të vazhdueshme të veprimtarisë të sistemit të drejtësisë.

Vetëm nëse arrijmë të krijojmë të realizojmë një fotografim të plotë dhe të saktë të gjendjes të sistemit të drejtësisë (*lidhur me kohën mesatare që i nevojitet një magjistrati për shqyrtimin gjyqësor, ecurinë dhe përfundimin e çështjeve të prapambetura në gjykata, ngarkesën e tyre*) mund të arrijmë të evidentojmë masa konkrete, vlerësime të sakta dhe strategji efektive të cilat përmbushin qëllimin për rritjen e cilësisë edhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë.

Statistikat e sistemit të drejtësisë kanë një impakt të rëndësishëm dhe në planifikimin e inspektimeve tematike të cilat prekin problematikën më thelbësore të sistemit të drejtësisë duke rritur efektivitetin e rekomandimeve. Qartësia, kuptueshmëria dhe saktësia e të dhënave statistikore kontribuon edhe në vlerësimin e ndikimit të inspektimeve tematike dhe institucionale të përfunduara.

Qartësia, kuptueshmëria dhe saktësia e të dhënave statistikore kontribuon edhe në vlerësimin e ndikimit të inspektimeve tematike dhe institucionale të përfunduara. Duke krahasuar statistikat e sistemit të drejtësisë para dhe pas çdo inspektimi, mund të vlerësohet më efektivisht impakti i rekomandimeve në përmirësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë si dhe besimi i publikut në këtë sistem. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që të sigurohet standardizimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe ndërtimi i sistemeve të integruara që garantojnë transparencë, gjurmueshmëri dhe akses të kontrolluar në informacion. Vetëm përmes një infrastrukture të tillë mund të arrihet që të dhënat statistikore të shndërrohen në një instrument real vendimmarrjeje, i cili mbështet një vlerësim të drejtë dhe të mbështetur në të dhëna të sakta. Njëkohësisht, ky proces nuk mund të kuptohet i shkëputur nga infrastrukture, kushtet materiale dhe funksionale në të cilat ushtrohet veprimtaria e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Për këtë arsye, përmirësimi i infrastrukturës dhe i sistemeve të gjykatave dhe prokurorisë përbën një komponent thelbësor, i cili ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e punës, në cilësinë e të dhënave.

Bashkëpunimi që po materializohet nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje synon të krijojë një qasje të unifikuar dhe të standardizuar në menaxhimin e statistikave të drejtësisë, duke garantuar që informacioni i prodhuar të jetë i aksesueshëm, i krahasueshëm dhe në funksion të vendimmarrjes së informuar. Përmes këtij angazhimi të përbashkët, institucionet tona, synojnë të rrisin cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbetet i përkushtuar në misionin e tij për të garantuar llogaridhënie dhe standarde të larta profesionale në sistemin e gjykimin dhe hetimit.

Në këtë kuadër, bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë në fushat me pikëprerje të përbashkët është një element thelbësor për të siguruar që çdo nismë të mbështetet mbi të dhëna të sakta dhe analiza të mirëfillta.

Dua të shpreh mirënjohjen time për Ministrinë e Drejtësisë dhe për të gjithë ata që kanë kontribuar në arritjen e kësaj marrëveshjeje. Jam i bindur se ky është vetëm fillimi i një bashkëpunimi të frytshëm, i cili do të sjellë rezultate konkrete dhe të prekshme në funksion të drejtësisë dhe të qytetarëve.

Duke përfunduar, më lejoni të theksoj se ndërtimi i një sistemi drejtësie të besueshëm është një proces i vazhdueshëm, që kërkon përkushtim, bashkëpunim dhe vizion afatgjatë. Marrëveshja që nënshkruajmë sot është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. Në këtë kuadër, për të adresuar këtë fazë zhvillimi dhe problematikat e sistemit sot, në këndvështrimin tim personal, duhet të mbajmë në konsideratë faktin, si dhe duhet të kuptojmë qartë, se reforma në drejtësi është një sipërmarrje dhe angazhim shumë i rëndësishëm për shoqërinë shqiptare.

Zbatimi i reformës në drejtësi është patjetër detyrë e institucioneve të drejtësisë. Por një proces kaq i thellë, i gjatë dhe kompleks, në kuptim të vlerave shoqërore dhe politike, që kjo reformë synon të kultivojë në shoqërinë shqiptare, kërkon domosdoshmërisht angazhimin e sistemit politik dhe institucional, si dhe të shoqërisë shqiptare në tërësi.



## FJALA E Z. METANI NË TAKIMIN E KËSHILLAVE PËR VLERËSIMET ETIKO-PROFESIONALE DHE ULJEN E BACKLOG-UT



*E nderuar Kryetare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, znj. Mirela Bogdani,*

*I nderuar Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi,*

*I nderuar Ministër i Drejtësisë, z. Toni Gogu,*

*I nderuar Prokuror i Përgjithshëm, z. Olsian Çela,*

*I nderuar Kryetar i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi,*

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë për të ndarë disa konsiderata në kuadër të këtij takimi të katërt të përbashkët të institucioneve tona. Kjo mbledhje e përbashkët vjen në një moment të rëndësishëm, i cili kërkon më shumë se reflektim, kërkon qartësi në qëndrime, koordinim real dhe vendimmarrje konkrete. *Sfida* që kemi sot përpara dhe jo vetëm në lidhje me tematikën e sotme, e cila ka të bëjë me *vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve*, por edhe shumë çështje të tjera në lidhje me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor, nuk është më vetëm identifikimi i problematikave, pasi ato janë tashmë të njohura, por aftësia jonë për t'i adresuar ato në mënyrë të qëndrueshme, me përgjegjësi institucionale dhe me rezultate sa më të shpejta dhe konkrete.

*Së pari*, në çdo rast ky proces duhet të jetë real dhe jo formal. Procesi i vlerësimit duhet të konceptohet dhe të ndërtohet si një mekanizëm i besueshëm, që funksionon në praktikë dhe prodhon rezultate të matshme.

Vlerësimi duhet të mbulojë të gjithë përvojën profesionale të magjistratëve, meritat e magjistratit, kualifikimin, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin e tij, duke respektuar parimin e pavarësisë së magjistratëve. Objektivat për zhvillimin profesional të magjistratit, duhet t'i përgjigjen nevojave reale, të cilat vinë nga vlerësimi i punës së tij, me qëllim që rekomandimet për përmirësim të jenë realiste dhe të mundshme për t'u realizuar. Objektivat për zhvillimin profesional të magjistratit duhet të burojnë nga përvoja konkrete e ushtrimit të funksionit dhe nga realiteti i përditshëm i punës. Jo nga modele të përgjithshme dhe as nga qasje të shkëputura nga praktika. Vetëm në këtë mënyrë, rekomandimet për përmirësim marrin vlerë të vërtetë, kur janë të zbatueshme, të matshme dhe kur kontribuojnë realisht në rritjen e cilësisë së ushtrimit të detyrës.

*Së dyti*, procesi i vlerësimit duhet ndërtohet në mënyrë të tillë që të sigurojë vlerësimin etik dhe profesional në kohë të magjistratëve. Mungesa e koherencës ndërmjet vlerësimit dhe promovimit të magjistratëve duhet minimizuar. Një sistem vlerësimi etiko-profesional që nuk bazohet në *meritokraci*, si dhe që nuk shërben si një mjet për karrierën e magjistratit, rrezikon të dobësojë vetë themelet mbi të cilat ndërtohet drejtësia dhe të krijojë perceptime të padrejta në opinionin publik në lidhje me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor. Nga ana tjetër, akumulimi i vlerësimeve të pambyllura është një tregues i qartë i një sistemi që nuk po funksionon me ritmin e duhur. Ky *backlog* krijon pasiguri, vonesa në zhvillimin e karrierës dhe dobëson efektivitetin e vetë procesit të vlerësimit.

Kjo situatë kërkon masa të menjëhershme për reduktimin e *backlogut*, por njëkohësisht edhe marrjen e një sërë masave që të parandalojnë rikrijimin e tij. Përshpejtimi i procesit kërkon jo vetëm angazhim, por edhe riorganizim dhe mekanizma të qartë monitorimi.

Së *treti*, një dimension po aq i rëndësishëm është cilësia e vetë procesit të vlerësimit. Ndërsa rishikimi i metodologjisë së vlerësimit etiko-profesional duhet të synojë më pak formalizëm dhe më shumë përmbajtje, thjeshtim të treguesve apo indikatorëve, përmirësim të të dhënave statistikore dhe rritje të peshës së elementeve, apo treguesve cilësore. Përmirësimi i cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave statistikore përbën një parakusht thelbësor për ndërtimin e një procesi vlerësimi etiko-profesional objektiv dhe të qëndrueshëm në kohë. Pa një bazë të dhënash të saktë, të plotë dhe të përditësuar, çdo përpjekje për vlerësim rrezikon të mbështetet në tregues të pjesshëm apo të pasaktë, duke cenuar dhe vetë integritetin e procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve.

Në këtë kuptim është e domosdoshme që të sigurohet standardizimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe ndërtimi i sistemeve të integruara që garantojnë transparencë, gjurmueshmëri dhe akses të kontrolluar në informacion. Vetëm përmes një infrastrukture të tillë mund të arrihet që të dhënat statistikore të shndërrohen në një instrument real vendimmarrjeje, i cili mbështet një vlerësim të drejtë dhe të mbështetur në të dhëna të sakta. Njëkohësisht, ky proces nuk mund të kuptohet i shkëputur nga infrastruktura, kushtet materiale dhe funksionale në të cilat ushtrohet veprimtaria e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Për këtë arsye, përmirësimi i infrastrukturës dhe i sistemeve të gjykatave dhe prokurorisë përbën një komponent thelbësor, i cili ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e punës, në cilësinë e të dhënave dhe për rrjedhojë, edhe në objektivitetin e procesit të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve.

### Të nderuar pjesëmarrës,

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve është një mekanizëm që funksionon vetëm nëse hallkat e tij janë të sinkronizuara. Çdo paqartësi në role, apo çdo vonesë në bashkëpunim prodhon efekte zinxhir në të gjithë pushtetin gjyqësor. Është koha që bashkëpunimi ndërinstitucional të mos mbështet mbi një *qasje formale*, por të kthehet në një mekanizëm funksional, të matshëm dhe të orientuar drejt rezultateve.

Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është i lidhur ngushtë me garantimin e integritetit dhe forcimin e llogaridhënies në pushtetin gjyqësor. Por duhet të jemi të qartë se kjo nuk është përgjegjësi e një institucioni të vetëm. Ai varet nga aftësia jonë për të vepruar si një sistem i koordinuar, ku çdo institucion kontribuon në mënyrë të matshme dhe në kohë, si dhe ku secili institucion luan rolin e tij kushtetues dhe ligjor. Në këtë kuadër vlen të theksohet se harmonizimi i standardeve ndërmjet KLP dhe KLGJ, ILD apo Prokurorit të Përgjithshëm është një domosdoshmëri. Një sistem me standarde të ndryshme nuk mund të prodhojë një proces të barabartë dhe as besim publik.

Kjo *qasje* nuk kërkon vetëm vullnet të mirë, por kërkon veprim real. Ky takim sotëm duhet të shërbejë pikërisht qëllim, duke kaluar nga analiza në veprim; nga identifikimi i problematikave në zbatimin e zgjidhjeve; si dhe nga pritshmëritë në rezultate konkrete. Jam i bindur se përmes këtij dialogu të përbashkët dhe angazhimit konkret institucional do të arrijmë të adresojmë sfidat ekzistuese dhe të ndërtojmë një proces vlerësimi etik-profesional për magjistratët më efektiv, më të drejtë dhe më funksional.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe kontributin tuaj, ju uroj punë të mbarë.

Faleminderit!



## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, LEKSION I HAPUR ME STUDENTËT E "LUARASI"



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një leksion të hapur me studentët e degës së drejtësisë në Universitetin Luarasi, ku ndau me ta reflektime mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë pas reformës, duke u ndalur tek veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pavarësia e gjyqësorit, llogaridhënia dhe ndarja e pushteteve.

Gjatë fjalës së tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani tha se reforma në drejtësi ka krijuar një arkitekturë të re institucionale, e cila përbën një strukturë të qëndrueshme dhe funksionale. Një ndër arritjet kryesore të kësaj reforme tha z. Metani është fakti që sot gjyqtarët dhe prokurorët ushtrojnë detyrën e tyre pa trysni apo presion, falë mekanizmave ligjorë dhe kushtetues që garantojnë hetimin dhe ndëshkimin e çdo shkeljeje të mundshme.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë sqaroi mënyrën se si vihet në lëvizje institucioni që ai drejton, duke theksuar se "procesi nis kryesisht nga ankesat e qytetarëve dhe institucioneve, por edhe me iniciativë të vetë ILD-së, bazuar në informacione të siguruar, përfshirë edhe nga mediat, por duhet që ankesat të jenë të qarta dhe të detajuara, duke përfshirë identitetin e gjyqtarit dhe përshkrimin konkret të shkeljes së pretenduar".

Një element thelbësor, sipas z. Metani, mbetet ruajtja e balancës mes pavarësisë së gjyqtarëve dhe llogaridhënies së tyre, çka garanton një sistem drejtësie të paanshëm dhe të pa shantazhueshëm. Inspektori i Lartë i Drejtësisë sqaroi gjithashtu se "ILD nuk ka kompetencë për të ndryshuar vendime gjykatash, ato ashtu sikurse është e parashikuar në ligj rrezohen, apo ndryshohen nga një shkallë më e lartë e sistemit gjyqësor".

Në vijim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpjegoi tre fazat e trajtimit të një anese: "verifikimin fillestar, hetimin mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm dhe procedimin disiplinor.

Ndër shkeljet më të shpeshta të konstatuara përmendi vonesat në zbardhjen e vendimeve, të cilat shpesh lidhen me ngarkesën e lartë të trupës gjyqësore. Inspektori i Lartë i Drejtësisë theksoi se qytetarët kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e tij pranë organeve përkatëse, si mekanizma kontrolli, si dhe vuri në dukje rëndësinë e inspektimeve në sistemin e drejtësisë, të cilat kontribuojnë në rritjen e performancës dhe besueshmërisë së tij".

Gjatë bashkëbisedimit me studentët, një vëmendje e veçantë i kushtua edhe ndikimit të procesit të vettingut në sistemin e drejtësisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë theksoi se vettingu ka sjellë përgjysmimin e numrit të gjyqtarëve, duke krijuar një ngarkesë të shtuar në sistem, por duke mbetur një proces i domosdoshëm për rritjen e integritetit dhe besimit publik.

Studentët ngritën pyetje mbi natyrën e shkeljeve në vendimmarrje dhe rastet kur këto mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, përfshirë edhe përmes korrupsionit. Në përgjigje të tyre, Inspektori sqaroi se çdo rast trajtohet mbi bazën e fakteve dhe procedurave ligjore, duke respektuar standardet e hetimit dhe balancën mes pavarësisë dhe përgjegjshmërisë.

Në lidhje me pyetjen rreth volumit të ankesave, z. Metani bëri të ditur se pranë institucionit janë depozituar mbi 9 mijë ankesa, nga të cilat më shumë se 6700 janë trajtuar. Nga këto, janë zhvilluar rreth 150 hetime ndaj magjistratëve dhe janë iniciuar 53 procedime disiplinore.

Në fund, Inspektori i Lartë i Drejtësisë bëri foli për inspektimet, për të cilat tha se ato mund të shërbejnë si bazë për reflektim institucional dhe përmirësime të mëtejshme, përfshirë edhe rekomandime, ndërsa shtoi se të gjitha raportet e inspektimit i janë adresuar Kuvendit.







INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË  
BULETINI MUJOR



ILD NË TWITTER

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Thellësisht i emocionuar e i nderuar nga mikpritja institucionale dhe njerëzore! 🇺🇸🇫🇷 Teksas&Florida #ILD 🇸🇰🇵🇸



VIZITË ZYRTARE E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË SHITE...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional të magistratëve 🇸🇰 është një mekanizëm që funksionon vetëm nëse hallkat e tij janë të sinkronizuara. #ILD #KLGJ #KLP 🇸🇰



FJALA E Z. METANI NË TAKIMIN E KËSHILLAVE PËR VLERËSIMET ETI...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Ndërtimi i një sistemi drejtësie të besueshëm është një proces i vazhdueshëm që kërkon përkushtim, bashkëpunim dhe vizion afatgjatë. Marrëveshja që nënshkruajmë sot është një hap i rëndësishëm në këtë drejtim. #ArturMetani #ILD 🇸🇰



FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË AKTIVITETIN E...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Ngritja e një të sistemi me të dhëna të aksesueshme statistikore i shërben matjes së performancës dhe efikasitetit të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorive, por edhe transparencës e llogaridhënies dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë 🇸🇰



ILD DHE MD NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR TË DHËNAT STAT...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

I lumtur që me Kryetarin e KLGJ dhe Prokurorin e Përgjithshëm bashkëbiseduam me juristë nga diaspora shqiptare. Si institucione duhet t'i kushtojmë marrëdhëniet me shqiptarët jashtë vendit të njëjtën vëmendje si atyre brenda vendit. 🇸🇰 #BALA



TRI INSTITUCIONE TË DREJTËSISË BASHKËBESIDIM ME JURISTË T...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

🇺🇸 për mundësinë e diskutimit me zyrën e OIG & OPDAT në Departamentin e Drejtësisë 🇺🇸 në Uashington DC 🇺🇸 mbi punën e ILD 🇺🇸. Diskutimet shumë të vlefshme mbi forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional & promovimin e sundimit të ligjit dhe vlerave demokratike.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOU NJË VIZITË ZYRTARE N...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

#ILD përmbyll procedurën e përzgjedhjes, emëron Elena Pelushin Zëvendësinpektore e Lartë e Drejtësisë. 🇸🇰



PERZGJIDHET ZËVENDËSINSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË - INSP...

From ild.al

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

Gjithmonë kënaqësi bashkëbisedimi me studentë 🇸🇰 e pedagogë 🇸🇰 të drejtësisë 🇸🇰. Interesi dhe angazhimi i tyre për shtetin e së drejtës japin shpresë për të ardhmen. #ILD #UniversitetiLuarasi



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, LEKSIONI I HAPUR ME STUĐEN...

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur...**  
@ILD\_Albania

📍 Përpunimi i javor i ankesave në #ILD

- ✅ 9019 të konfirmuara
- ✅ 6745 të trajtuara
- ✅ 2274 në proces trajtimi
- ✅ 148 në proces verifikimi
- ✅ 148 magistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor
- ✅ 18 inspektime të përfunduara

Na thoni eksperiencë me ne 🇸🇰  
[ild.al/sq/ankete/](http://ild.al/sq/ankete/)



9,019+	6,745	2,274	148
Confirmation	Processed	Open for review	Disciplinary requests
148		53	
Disciplinary requests		Disciplinary requests	

Thematic and Institutional Inspections

30 18

PRILL 2026


Të gjitha të drejtat e rezervuara  
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

## KONTAKT

Web: [ild.al](http://ild.al)  
Tel: +35542217217  
Email: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,  
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!